



Prishtinë, 05.07.2023  
Kodi i ZRRE-së: V\_1747\_2023

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_2425\_04\_23** i dt.24.04.2023;
- Kundërshtimi i KESCO-s i datës **15.05.2023**.

në seancën e mbajtur më datë **05.07.2023** nxori këtë:

### V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kundërshtimi i KESCO-s ndaj vendimit të DMK-së, për konsumatorin R.M nga Komuna e Drenasit, si e pa bazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, me nr. ZRRE/DMK\_V\_2425\_04\_23 i dt.24.04.2023.

### A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, me datë 24.04.2023 ka marrë Vendim me nr. ZRRE/DMK\_V\_2425\_04\_23 me të cilin e ka aprovuar ankesën e konsumatorit, me të cilën ankesë e ka kontestuar përgjigjën e KESCO-s – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 15.02.2023 lidhur me kontestimin e korrigjimit plotësues nr. 101398DPR-202761 datë 21.12.2022, për shkak të matjes jo të saktë të njehsorit elektrik nr.6175266.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, i licencuari KESCO, brenda afatit ligjor ka paraqitur Kundërshtim në Bordin e ZRRE-së, për këto shkaqe:

- Kundërshton vendimin e DMK-së dhe konstaton se i njëjti është i padrejtë;
- Pretendon se korrigjimi nr. 101398DPR-202761 datë 21.12.2022 është reale;
- Apeluesi KESCO kërkon nga Bordi i ZRRE-së që të pezullojë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK\_V\_2425\_04\_23 i dt.24.04.2023 për konsumatorin R.M.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 05.07.2023 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimin se korrigjimi nr. 101398DPR-202761 datë 21.12.2022 është i saktë, Bordi pas shqyrtimit të të gjitha provave dhe shkresave si: Procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit



elektrik nr. 0048356 datë 06.11.2021; Procesverbali i kontrollimit detal të njehsorit elektrik Nr.org.02Nr. 9925 datë 10.08.2022; korigjimi nr. 101398DPR-202761 datë 21.12.2022; Përgjigja e KESCO-s datë datës 15.02.2023; Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së datë 20.02.2023; Vendimi i DMK-së ZRRE/DMK\_v\_2425\_04\_23 i dt.24.04.2023, Transaksionet e konsumatorit; Rrjedha e energjisë elektrike si dhe listat e leximi gjeti se korigjimi nr. 101398DPR-202761 datë 21.12.2022 nuk është i saktë, andaj nuk ka dyshime që vendimi i marrë nga DMK-ja është vendim i drejtë dhe i ligjshëm.

ZRrE ka vërejtur se, me datë 06.11.2021 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për ndërrim njehsori kanë inspektuar piken matëse të konsumatorit ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 6175266 me gjendje TL=50556 kWh dhe TU=000003 kWh si dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 57698571 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh. Ekipet e KEDS-it kane evidentuar se behet ndërrimi i njehsorit mekanik ne PLC dhe se njehsori i vjetër dërgohet ne qendrën e kalibrimit. ZRRE ka analizuar procesverbalin e përpiluar nga ekipet e KEDS-it dhe konstaton se ne procesverbal nuk është evidentuar se njehsori elektrik është i dëmtuar ne çfarëdo forme. Me datë 10.08.2022 punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 6175266 me gjendje te shpenzimeve TL=50556 kWh dhe TU=00003 kWh ku kanë konstatuar se: njehsori elektrik bllobat(vulat) i ka në rregull, nga ana e jashtme njehsori pjesën kyçëse e ka te djegur. Ne brendi te njehsorit komisioni nuk ka vërejtur ndonjë parregullsi.

Bazuar në analizën e përgjithshme të energjisë elektrike me njehsorin e vjetër elektrik si dhe njehsorin e ri elektrik konstatohet se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve mujore por që ne periudha te shumta lexuesi i KEDS-it gjatë leximeve te shpenzimeve mujore me njehsorin e vjetër ka evidentuar se nuk ka qasje ne leximin e njehsorit elektrik. Sipas listave te leximit po ashtu vërtetohet se lexuesi i KEDS-it ne periudhën 06/2021 ka evidentuar se duhet te behet ndërrim njehsori si dhe duke evidentuar " Numër serial i ndryshëm" por qe as ne periudhat e me hershme e as te me vonshme nuk ka evidentuar se njehsori elektrik nr. 6175266 është i dëmtuar ne çfarëdo forme. Bordi i ZRRE po ashtu vëren se konsumatori ka dallim edhe ne shpenzimin e energjisë elektrike me njehsorin e ri dhe te vjetër per periudha te njëjta kohore si dhe ka rritje te shpenzimit menjëherë pas ndërrimit te njehsorit elektrik. Mesatarja e shpenzimeve te konsumatorit me njehsorin e ri nr. 57698571 per periudhën 06/2022 deri ne periudhën 11/2022 është **868 kWh/muaj** kurse me njehsorin e vjetër kontestues nr. 6175266 periudha 07/2021 deri ne periudhën 10/2021 është **390 kWh/muaj**, periudha 06/2020 deri ne periudhën 11/2020 është **295 kWh/muaj**. ZRRE po ashtu konstaton se konsumatori nga fillimi përkatësisht nga periudha 08/2002 deri me datë 06.11.2021 kur edhe është larguar nga matja njehsori kontestues është faturuar vetëm me shpenzimet ne tarifën e lartë kurse pas ndërrimit te njehsorit elektrik konsumatori ka shpenzime te regjistruara ne dy tarifat.

Me datë 21.12.2022 Departamenti i faturimit në KESCO bazuar në procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr. 0048356 datë 06.11.2021 dhe procesverbalin e kontrollimit detal të njehsorit elektrik Nr.org.02Nr. 9925 datë 06.08.2022 përmes korigjimit nr. 101398DPR-202761 ka bërë korigjimin plotësues në vlerë **169.95€** për faturat e periudhës 05/2021(15 ditë) deri ne periudhën 11/2021(11 ditë) duke ri faturuar faturat e asaj periudhe me shpenzimet e periudhës 05/2022 deri periudhën 11/2022 te regjistruara ne njehsorin e ri nr. 57698571. ZRRE ka shqyrtuar korigjimin plotësues të bërë nga Departamenti i faturimit në KESCO dhe duke pasur parasysh rrjedhën e energjisë elektrike ku konsumatori nga fillimi me njehsorin kontestues është faturuar me një tarife te vetme, pra i ka takuar grupit tarifar 6(4/01), listave te leximit ku nuk është evidentuar arsyeja e kërkesës se lexuesit te KEDS-it per ndërrim njehsori dhe se ne asnjë rast nuk është evidentuar se njehsori është i dëmtuar ne çfarëdo forme përfshi edhe se ka te djegur pjesën kyçëse, procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr. 0048356 datë 06.11.2021 ku nuk është evidentuar se njehsori elektrik është i dëmtuar ne çfarëdo forme dhe se ndërrimi i njehsorit është bërë me një vonesë 5 mujore nga data e evidentuar nga lexuesi ne listat e leximit, procesverbalin e kontrollimit detal të



njehsorit elektrik Nr.org.02Nr. 9925 datë 06.08.2022 ku është evidentuar se njehsori ka te djegur pjesën kyçëse konstaton se ka mos përputhje ne mes te procesverbaleve dhe dokumenteve tjera dhe se ky korrigjim i faturimit plotësues duhet te anulohet.

Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se i licencuari KESCO në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 05.07.2023 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, e ne veçanti rrjedhën e energjisë elektrik, listave te leximit, procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr. 0048356 datë 06.11.2021 dhe procesverbalin e kontrollimit detal të njehsorit elektrik Nr.org.02Nr. 9925 datë 06.08.2022, korrigjimin nr. 101398DPR-202761 datë 21.12.2022 ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

**III.** Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versionin në gjuhën shqipe.

**IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

\_\_\_\_\_  
Ymer Fejzullahu, Kryesues

\_\_\_\_\_  
Lutfije Dervishi, anëtare

\_\_\_\_\_  
Gani Buçaj, anëtar

**Vendimi u dërgohet:**

- KESCO-s,
- Konsumatorit R.M dhe
- Arkivit të ZRRE-së.

